

BULETINI MUJOR



NËNTOR 2023

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



NIS RINDËRTIMI I SPITALIT PSIKIATRIK TË VLORËS

Rindërtimi i Spitalit Psikiatrik të Vlorës me fondet e buxhetit të shtetit do të plotësojë kushtet dhe standardet për pacientët që vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor kronik. Krahas këtij investimi, ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçi, e konsideroi me rëndësi edhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit për t'u ofruar shërbim sa më dinjitoz të pacientëve.



MARRËVESHJE ME ZVICRËN PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçi, si dhe ambasadorja e Zvicrës në Tiranë, Ruth Huber, nënshkruan dy marrëveshje që forcojnë më tej sistemin e kujdesit shëndetësor parësor dhe aksesin në shërbime pranë vendbanimit të qytetarëve tanë.



BUXHETI 2024, 98.72 MILIARDË LEKË PËR SHËNDETËSINË DHE MBROJTJEN SOCIALE

Buxheti prej 98.72 miliardë lekë është më i lartë i akorduar ndonjëherë më parë për sektorin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pothuajse 68 miliardë lekë mbështet direkt shëndetësinë, ndërsa pjesa tjeter prej 30 miliardë lekësh për qytetarë që kanë më shumë nevojë.

RRETH 120 MIJË PERSONA TË VAKSINUAR KUNDËR GRIPIT

Vaksinimi falas kundër gripit të stinës për grupet e rrezikuara, si personeli shëndetësor, fëmijët, gratë shtatzëna, të sëmurët kronikë dhe të moshuarit, po vijon në të gjithë vendin, si mënyra më e mirë dhe e sigurt për të parandaluar format e rënda të gripit.

OPERACIONI I SUKSESSHËM I FËMIJËS ME SINDROMËN E RRALLE

Ekipi mjekësor i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" ka realizuar një ndërhyrje të kompleksitetit të lartë te një fëmijë, i cili ishte diagnostikuar me një sindromë të rrallë, "FHEIG Sindrome", i pari rast i evidentuar në Shqipëri.



www.shendetesia.gov.al



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



QENDRA E RE “FUQIZOJMË KOMUNITETIN” NË DURRËS

Në Durrës është përvizuar Qendra “Fuqizojmë Komunitetin” për ofrimin e shërbimeve të integruese, socio-shëndetësore për qytetarët në nevojë. Kjo nismë e përbashkët me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe amerikanë është shprehje e qartë e vullnetit të qeverisë shqiptare për të mos lënë asnjë pas. “Fuqizojmë Komunitetin”, do të jetë shembull suksesi dhe udhërrëfyesi i MSHMS që në bashkëpunim me aktorë në nivel vendor dhe qendror, të shtrihet në të gjitha bashkitë e vendit.



RIKONSTRUKTOHET QENDRA SHËNDETËSORE NË BATHORE

Qendra Shëndetësore e Bathores, Kamëz është rikonstruktuar tërësisht si pjesë e programit madhor të qeverisë për transformimin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin. Falë këtij investimi është mundësuar transformimi i mjediseve që do të ofrojë kushte bashkëkohore dhe shërbime të reja socio-shëndetësore për rreth 16 mijë banorë të kësaj zone. Prioritet është edhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit parësor për të sëmurët në banesa të cilët e kanë të pamundur të paraqiten në strukturën shëndetësore.



PARANDALIMI I DHUNËS NDAJ GRAVE, KAUZË QË NA PËRKET TË GJITHËVE

Në kuadër të 16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore ka nisi fushata, “Investo për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave!”, organizuar nga MSHMS në bashkëpunim me organizatën e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. MSHMS përmes Fondit Social ka vazhduar të mbështesë shërbimet përgatitjeve dhunuara. Rritja e ndërgjegjësimit, forcimi i strukturave, si dhe përgjigjja e koordinuar për rastet e dhunës në familje kanë rritur edhe numrin e procedimeve penale, paditë dhe urdhurat e mbrojtjes.



BASHKËPUNIM ME MJEKËT E DIASPORËS PËR OFRIMIN E STANDARDEVE EVROPIANE PËR QYTETARË

Samitit i III-të i Diasporës mbajtur në Tiranë, bëri bashkë pjesëmarrës nga vende të ndryshme, si nga Kosova, Spanja, SHBA-të, Holanda, Italia, Anglia dhe Greqia. Në panelin “Shkëmbimi i eksperiencës, kontributi dhe roli i mjekëve nga Diaspora në Shqipëri”, u diskutua për zhvillimet teknologjike në fushën e shëndetësisë dhe inovacioni shëndetësor. Me rëndësi u nënvizua bashkëpunimi mes mjekëve që jetojnë jashtë dhe atyre që jetojnë e punojnë në Shqipëri, për turizmin shëndetësor.